

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I DYTË- SEMESTRI III

E Drejta Civile [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me njohuritë e duhura për tërësinë e dispozitave juridike-civile, me të cilat rregullohen marrëdhëniet shoqërore të karakterit pasuror. E drejta civile përfshin trajtimin bashkëkohor të parimeve të përgjithshme për marrëdhëniet civile-juridike dhe institucionet e përbashkëta për të gjitha marrëdhëniet juridike civile.

E Drejta Penale – pjesa e përgjithshme [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në të drejtat materiale penale, duke përfshirë veprat penale, përgjegjësinë penale, rëndësinë e aktit, qëllimin, shkakun dhe rezultatet si dhe dënimet me llojet e saj. Të njihen, mjaftueshëm, me të drejtën penale, ligjin penal, dënimin dhe pasojat juridike të veprës penale, veprën dhe përgjegjësinë penale të kryerësit, etj.

E Drejta Administrative [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuri të mjaftueshme për parimet e organizimit, punën dhe fushëveprimin e organeve administrative, veprimtarinë themelore që e përbëjnë funksionin administrativ, aktet e organeve administrative dhe raportet në mes qytetarve dhe administratës.

E Drejta Familjare dhe Trashëgimore [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët pas përfundimit të këtij kursi, të kenë njohuri për rregullimin e raporteve familjare në përgjithësi, raportet personale midis bashkëshortëve, raportet e pronësisë familjare, birësimin, raportet prindër-fëmijë, kujdestarin dhe shkurorëzimin, trashëgiminë testamentale. Studentët do të njohohen me rregullimin juridik të kalimit të pronës së individit në personat tjerë, në rast vdekjes së tij.

Gjuhë Gjermane [Z]:

Qëllimet e kësaj lënde janë, që studentët të pajisen me dituri të konsiderushme të gjuhës gjermane, për nevojat profesionale juridike, të aftësohen në konceptet e fushës së juridikut, duke arritur që tesktet dhe materialet punuese, të jenë në gjendje t'i analizojnë dhe flasin gojarisht, apo shkruajnë me shkrim.

Gjuhë Latine juridike [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njoftohen me gjuhën, kulturën dhe historinë romake, do t'i shohin termat dhe materialet latine, që ndërlidhen me fushën juridike, të jenë në gjendje t'i dallojnë historitë sociale dhe politikat e romakëve, në çështjet juridike. Gjithashtu studentët do të aftësohen dhe njoftohen me fushat gramatikore të gjuhës latine, duke krahasuar me gjuhën shqipe dhe gjuhët tjera ndërkombëtare.

Kompetenca Ndërkulturore [Z]:

Qëllimi i këtij kursi është rritja e aftësisë së studentit për të punuar në një ambient me kultura të ndryshme. Kursi ka për qëllim edhe masterizimin e kulturave, përfshirë racën, nacionalitetin edhe gjinitë. Në disa tema, diskutohet edhe rëndësia e medias, sa u përket aspekteve kulturore. Studentët do të shohin interaksionin në rritje, të kulturave të ndryshme dhe bashkëpunimi në mes tyre, në aspekte kulturore, të njoftohen edhe me termat e globalizmit, migrimit, diversitetit të kulturave, etj.

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I DYTË - SEMESTRI IV

E Drejta Ndërkombëtare Publike [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuri të konsiderueshme të rendit botëror dhe rregullave nga të cilat varet paqja, siguria dhe mirëqenia e njerëzimit. Të aftësohen në marrëdhëniet në mes të drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm, çështjet e së drejtës ndërkombëtare publike, përgjegjësinë e shteteve, të drejtat ndërkombëtare të njeriut, ligjet e traktateve, ligjet e organizatave ndërkombëtare, rezolutat, etj.

E Drejta Penale- pjesa e posaçme [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me ligjin penal, llojet e veprave penale të posaçme dhe sanksionet penale ndaj tyre, të sistemuara sipas objektit mbrojtës siç janë: veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare, veprat kundër jetës dhe trupit, kundër lirive dhe të drejtat e njeriut, kundër sigurisë së trafikut publik, kundër detyrës zyrtare, etj.

Kriminalistikë [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në çështjet themelore të teknikës, taktikës dhe metodikës kriminalistike, se si vihet deri te zbulimi i kryerësve të veprës penale, të aftësohen në regjistrimin kriminalistikë, identifikimin kriminalistikë të njerëzve të gjallë, të trupave pa jetë, etj.

E Drejta Sendore [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me mënyrat bashkëkohore të parimeve të së drejtës sendore, të së drejtës pronësore në veçanti, si dhe institucioneve tjera juridike të së drejtës sendore. Kjo përfshinë tërësinë e studimeve që u referohen normave juridike-civile, me të cilat rregullohen marrëdhëniet e subjekteve lidhur me sendet.

Statistikë Ligjore [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuri të mjaftueshme, rreth statistikave ligjore, statistikave të cilavt përdoren dhe përpunohen për çështje ligjore, statistikave të cilat kanë rëndësinë e tyre në rastet ligjore. Studentët do të aftësohen në statistikave ligjore që zakonisht përdoren në situatat që nuk kanë rezultate numerike të mjaftueshme dhe pastaj sjellin numra jo efektiv në çështjet dhe proceset ligjore.

Rezonimi Juridik [Z]:

Qëllimet e kësaj lënde janë, që studentët pas përfundimit të këtij kursi, të aftësohen në analizimin e vendimeve juridike, si dokumente gjuhësore, natyrore, që të rifitojnë elementet e rezonimit juridik dhe argumentet. Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë argumentet në raste, duke përfshirë politikave e bazuara në rezonim dhe evidencat e bazuara në arsyetim si dhe mangësitë ligjore të provave të pranuar.

Negocimi [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me teorinë, aftësitë themelore dhe etikave të përfshira në negociatave. Përmes kombinimit të ushtrimeve dhe ligjeratave, studentët do të jenë në gjendje të zhvillojnë një kuptim të dinamikës së negociatave dhe qasjet në dispozicion për avokatët e angazhuar në këtë proces, të aftësohen në procesin e negociimit në mes palëve, rrjedhat dhe proceset që zhvillohen gjatë negociimit.